

Nr: 71/2023	Nr: Protokoli: 104/2023
Për:	Operatorin Ekonomik: Albi Company SH,P,K
Nga:	Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit: Fatos Kuqi
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	21.09.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Suharekës në mbështetje të nenit 108/A paragrafi 10.1 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, sa i përket **Kërkesës për Rishqyrtim**, të parashtruar me datë: 18.09.2023 nga Operatori Ekonomik: **Albi Company SH,P,K** me adresë në Rahovec lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Ndertimi i Lapidarit - muzeut ne Studenqan 2 lot –Ritender** me me Numër të prokurimit: 624-23-9383-5-2-1 Numër i brendshëm: 624-23-65-521 nxjerr këtë:

VENDIM

- I. **REFUZOHET Kërkesa për Rishqyrtim** e parashtruar nga Operatori Ekonomik: **Albi Company SH,P,K** me adresë në Rahovec lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Ndertimi i Lapidarit - muzeut ne Studenqan 2 lot –Ritender** me Numër të prokurimit: 624-23-9383-5-2-1 Numër i brendshëm: 624-23-65-521 kundër: **(NJOFTIM PËR KONTRATË)**, të datës: 04.09.2023 të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të **REFUZOHET Kërkesa për Rishqyrtim** për aktivitetin e prokurimit: **Ndertimi i Lapidarit - muzeut ne Studenqan 2 lot –Ritender** me Numër të prokurimit: 624-23-9383-5-2-1 Numër i brendshëm: 624-23-65-521
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

ARSYETIM

Operatori Ekonomik: **Albi Company SH,P,K** me adresë në **Rahovec** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Ndertimi i Lapidarit - muzeut ne Studenqan 2 lot – Ritender** me Numër të prokurimit: **624-23-9383-5-2-1** Numër i brendshëm: **624-23-65-521**

kundër (**NJOFTIM PËR KONTRATË AK**) , të datës: **04.09.2023** të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **18.09.2023** sipas **nenit 108/A**, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. **04/L-042** i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. **04/L-237**, ligjin Nr. **05/L-068** dhe ligjin Nr. **05/L-092**

Autoritetit Kontraktues ka projekt ekzekutiv për këtë aktivitet të prokurimit dhe në përgjigjen e kërkesës për sqarim të ngarkuar në platformë ju kemi ftuar që ta marrim të njëjtin në Drejtorin e Kulturës, Rinis, Sport dhe Mërgatë por që ju nuk keni shprehur interesim për një gjë të tillë.

Në kërkesën për rishqyrtim ju disa herë e keni potencuar një projekt ekzekutiv ku keni pretenduar që nuk korespondon me parametrat dhe paralogarin e publikuar, nëse si AK nuk e dimë për cilin projekt e keni fjalën.

AK ka bërë korrigjimin në bazë të kërkesës suaj për sqarim shtesë dhe ka ngritur parametrimin dhe paralogarin e korrigjuar.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi të AK-së ju mundë të paraqitni ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit

Komuna e Suharekës

